



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

FAKULTETI I Drejtësisë

Departamenti i së Drejtës Nderkombëtare Evropiane

Shkodër, me 22.02.2017

Lënda: Njoftim punësimi Departamentin e së Drejtës Nderkombëtare Evropiane

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi, në Fakultetin e Drejtësisë” shpallet konkursi për vende të lira pune, në pozicionin lektor/c, i/c jashtë në Departamentin e së Drejtës Nderkombëtare Evropiane:

1. Pedagog me kohe të pjesshme për lenden: E drejta nderkombëtare private Msc
2. Pedagog me kohe të pjesshme për lenden: E drejta e pronësive intelektuale Msc

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

Të kenë zotësi të plotë veprimi.

Të mos kenë procedim penal të filluar ndaj tyre e të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale të dënueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Të mos jenë larguar nga USH pa miratimin e këtij të fundit.

Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort, bashkëjetues, bir, bij dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo krushqie (prind, fëmijë, vëlla, motër, bashkëshort dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës ekzistues brenda Fakultetit të Drejtësisë.

Të kenë kryer studimet universitare dhe pasuniversitare me jo më pak se 300 kredite në fushën e të drejtës.

Diplomat e studimeve universitare dhe pasuniversitare të jenë në fushën për të cilën aplikon kandidati.

Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MAS-i.

Të kenë kryer arsimin e lartë në sistemin me kohë të plotë, në degën juridik me notë mbi 8.5.

Nota mesatare e përgjithshme e studimeve në diplomën e sistemit të vjetër të jetë jo më pak se 8.5.

Nota mesatare e përgjithshme e studimeve Master të jetë mbi 9.

Nota mesatare e grup-lëndëve, për të cilat aplikon kandidati të jetë mbi 9.

Të kenë dhënë provim universitar dhe/ose pasuniversitar lëndën për të cilën pretendojnë të jenë lektorë.

Prefërohen që kandidatët të kenë:

mbaruar studimet universitare dhe pasuniversitare në universitete perëndimore;

eksperiencë mësimdhënieje në universitete publike brenda ose jashtë vendit për lëndet për të cilat është hapur konkursi.

Kandidatët do t'i nënshtrohen konkurrimit sipas përcaktimit në Rregulloren për zënie e ruajtjen e vendit të punës të USH-se.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim në të cilën të specifikohet lënda për të cilën kandidon..
2. Curriculum Vitae me foto personale.
3. Dëshmi Doktorature, MND ose DND dhe e provimeve pasuniversitare të njohura zyrtarisht.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave origjinale ose të noterizuara.
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurohet.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.

7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
9. Vërtetim nga prokuroria, gjykata si dhe dëshmi penaliteti.
10. Raport mjeko-ligjor.
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon ose vërtetim papunësie nga Zyra e Punës
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për Zënien dhe Ruajtjen e vendit të punës (për moslidhje farefisnore).
13. Dokument identifikimi vejtak (fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
14. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
15. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme dhe/ose kërkesave të Rregullores për zënien e ruajtjen e vendit të punës të USH-se si dhe ligjit 80/2015.

Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të jenë origjinale ose të fotokopjuara dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtori i Departamentit

Dr. Senada Reçi

